



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:167329

Datë: 11.05.2022

Numri i dokumentit: 02997160

Ac.nr.6706/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit T.B, nga fshati “.....”, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari i tij av. Y.K, nga Prizreni, kundër të paditurit Këshilli i Bashkësisë Islame, me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z.I, nga Prizreni, për shkak të pengim posedimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1718/2020, të datës 29.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën **28.04.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit Këshilli i Bashkësisë Islame, me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1718/2020, i datës 29.06.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar C.nr.1718/2020, të datës 29.06.2021, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, T.B, nga fshati “.....”, Komuna e Prizrenit si të bazuar, në pikën II të dispozitivit ka vërtetuar se e paditura, Këshilli i Bashkësisë Islame me seli në Prizren, e ka penguar paditësin në posedim dhe shfrytëzim e lirë të tokës bujqësore që shtrihet në ngastrën kadastrale nr.3985 ZK, Zhur në sipërfaqe prej 11235m2 dhe njëkohësisht paditësin e ka larguar nga kjo tokë. Në pikën III të dispozitivit gjykata, e ka detyruar të paditurën Këshilli i Bashkësisë Islame me seli në Prizren, që t’ia lejojë paditësin, të posedoj dhe të shfrytëzoj lirshëm tokën bujqësore në ngastrën kadastrale nr.3985 ZK dhe tani e pas të paditurës, i urdhërohet që ndaj paditësit, të mos kryej pengimi posedimin e njëjtë ose të ngjashëm, ndërsa në pikën IV të dispozitivit, gjykata ka detyruar të paditurën, Këshilli i Bashkësisë

Islame me seli në Prizren, që paditësit T.B nga fshati “.....”, Komuna e Prizrenit, në emër të shpenzimeve procedurale, t’ia paguaj shumën prej 850.00 €, e të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditësh pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, i padituri ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e të paditurit si të bazuar, ndërsa ta prish aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1718/2020, të datës 29.06.2021, dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit, është e **pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi T.B, më datën 01.12.2020, ka parashtuar padi në gjykatën e shkallës së parë, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se policia e me urdhërin e të paditurit Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren e ka ndaluar paditësin në posedimin dhe shfrytëzimin e lirë të tokës bujqësore që shtrihet në p.k.nr.3985 ZK Zhur në sipërfaqe prej 11235m2 dhe njëkohsisht paditësin e ka larguar nga kjo tokë, andëj për këtë detyrohet i padituri që ta lejojë paditësin të posedojë dhe shfrytëzojë lirshëm tokën bujqësore dhe tani e më pas i urdhërohet që ndaj paditësit të mos kryej pengim posedimin e njëjtë ose të ngjajshëm, si dhe të detyrohet i padituri që të paguaj shpenzimet e procedurës.

Duke vepruar sipas kësaj padie gjykata e shkallës së parë zhvilloi procedurën gjyqësore dhe vendosi si në dispozitiv të aktvendimit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, përfshirë: shkresën me nr.230/19, të datës 25.03.2019 të KBI në Prizren, lidhur me dhënien me qira të parcelave në fshatin, fletë aplikacionin për marrjen e lokalit me qira, certifikata 07-029-6748-Ç, e datës 06.12.2016, e lëshuar nga drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren, ankesa e datës 23.04.2019, e paditësit drejtuar KBI-së në Prizren, ekspertiza e gjeodezisë e datës 19.04.2021, e përpiluar nga eksperti K.G, dëgjimi i dëshmitarëve E.G, M.F, D.O, S.B (*si dhe prova të tjera si në shkresat e lëndës*), dhe pas shqyrtimit të këtyre provave dhe dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, mes tjerash, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të provave të administruara ka vërtetuar gjendjen faktike në favor të paditësit, pasi që është provuar fakti si paditësi ka qenë në posedim e fundit faktik të tokës bujqësore e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr.3985 ZK Zhur, i cili fakt është vërtetuar në bazë të këqyrjes në vend dhe raportit me shkrim-ekspertizës së bashku me skicën e ekspertit të

gjeodezisë, andaj gjykata ka konstatuar se i padituri e kishe penguar paditësin në posedimin e kësaj ngastre, duke e lajmëruar rastin në policinë cilët në mënyrë të kundërligjshme, pa pasur ndonjë vendim të gjykatës apo të ndonjë organit tjetër e kanë larguar paditësin nga posedimi dhe shfrytëzimi i ngastrës në fjalë. Pas shqyrtimit të të gjitha provave, gjykata ka konstatuar se paditësi ishte posedues i fundit i ngastrës në fjalë, dhe i njëjti është larguar nga kjo tokë bujqësore, gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, D.O dhe S.B. Ndërsa, vendimin mbi shpenzimet procedurale e ka mbështetur në nenin 449, 452 par.1 dhe nenin 463 të LPK-së, dhe sipas Tarifës së Odës Avokatëve.(*më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktvendimit*).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu, ky aktvendim nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadiës së paditësit, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye, aktvendimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke krijuar kështu harmoni logjike e juridike mes dispozitivit e arsyetimit. Përkatesisht, i njëjti është hartuar në përputhje të plotë me nenin 160 të LPK-së. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelsinë e kërkesëpadiës së paditësit, e në lidhshmëri me këtë, ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Për këto arsye, refuzohen si të pabazuara pretendimet ankimore sipas të cilave gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të tilla, me rastin e hartimit të vendimit gjyqësor.

Në rastin konkret, pas shqyrtimit të ankesës së të paditurit, por edhe shkresave të lëndës, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, pasi që është konstatuar se pala e paditur ka penguar paditësin në posedimin e qetë dhe të lirshëm të pjesës së paluajtshmërive të përmendura sikurse në dispozitivin e aktvendimit të atakuar. Me nenin 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore (LPDTS), parashihet se “*Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*”, kurse me nenin 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se “*Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta*”, ndërsa me paragrafin 2 të tij ceket se “*Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore*”. Në rastin konkret është provuar fakti nga gjykata e shkallës së parë se posedues faktik i tokës bujqësore e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr.3985 ZK Zhur, është paditësi

përkatësisht dhe si i tillë ai ka të drejtë të plotë në posedim dhe shfrytëzimin e kësaj ngastre. Andaj, gjykata e shkallës së parë më të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike në favor të paditësit, dhe këtë fakt e ka dhe raportit me shkrim-ekspertizës së bashku me skicën e ekspertit të gjeodezisë, në bazë të cilave është vërtetuar se nga ana perëndimore ngastra kontestuese, shfrytëzohet me kulturë arë e mbjellë me grurë në sipërfaqe prej 5480 m², ndërsa në anën lindore pjesë e kësaj ngastre shfrytëzohet me kulturë livadh (me barë natyral) në sipërfaqe prej 2534 m² në anën veri-lindore, dhe 2628 m² në anën jug-lindore, ndërsa në mes sipërfaqja e lëvrua. Ndër të tjera që paditësi është posedues i ngastrës kontestuese dhe të njëjtën e ka lëvruar, gjykata e ka vërtetuar përmes deklaratave të dëshmitarëve siç janë: E.G dhe M.F, përndryshe zyrtarë policor të Kosovës, të cilët edhe e kanë zbatuar urdhrin e nën komandantit të stacionit të, për ndërprerjen e shfrytëzimit të ngastrës kontestuese. Po ashtu se paditësi ishte posedues i fundit i ngastrës në fjalë, dhe i njëjti është larguar nga kjo tokë bujqësore, gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, D.O dhe S.B, të cilët kanë pohuar se pasi që e kanë parë paditësin me familjen e tij duke lëvruar arën me traktor, e në anën tjetër qiramarrësi tjetër (A.B) ka qenë i penguar nga paditësi për të njoftuar tokën dhe për këtë e ka njoftuar edhe policinë. Përveç kësaj edhe vetë i padituri asnjëherë gjatë shqyrtimeve dhe fjalën përfundimtare nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka qenë në posedim të paluajtshmërisë kontestuese, andaj gjykata e shkallës së dytë konsideron se gjykata me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi ka pasur në posedimin e fundit ngastrën me nr.3985 përkatësisht tokën bujqësore të cilën e ka lëvruar për të mbjellë kultura të ndryshme, ndërsa i padituri më datën 16.1.2020, e kishte penguar të njëjtin në posedimin e kësaj ngastre, pa pasur ndonjë vendim të gjykatës apo të ndonjë organit tjetër e kanë larguar paditësin nga posedimi dhe shfrytëzimi i ngastrës në fjalë.

Tutje, gjykata vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar brenda kornizës ligjore të parapar me nenin 480 të LPK-së ku parashihen decidivisht kufizimet ligjore në raport me objektin e shqyrtimit: *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfundohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përfundohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të 93 posedimit të parashtrrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit”*. Andaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurit, se gjykata e shkallës së parë nuk ka provuar në mënyrë të mjaftueshme çështjen në fjalë. Në lidhje me çështjen në fjalë, e duke u bazuar në nenin të lartcekur, gjykata e shkallës së parë me të drejtë është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit. Në kuptim të kësaj dispozite rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit. Me mënyrën e vendosjes në këtë procedure, kjo gjykatë në asnjë mënyrë nuk prejudikon ndonjë të drejtë pronësore, apo të drejtë tjetër sendore të cilës do nga palët ndërgjyqëse, për çka ata eventualisht mund të inicojnë padi tjetër dhe me bazë tjetër të saj.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur, të theksuara në ankesën e parashtruar, ku përveç që i padituri nuk ka ofruar ndonjë bazë mbi të cilën Gjykata e Apelit do të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, i njëjti, edhe për ato shkelje që i ka pretenduar, nuk ka dhënë sqarime të mjaftueshme, duke e bërë kështu ankesën të mangët në kuptim të nenit 178, pika c), të LPK-së.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, automatikisht vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, me të cilin është obliguar pala e paditur si humbëse e kontestit, për kompensimin e shpenzimeve procedurale palës paditëse, konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga të lartëcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6706/2021, datë 28.04.2022

Kryetari i Kolegjit,
Lumni Sallauka